

VENDIM
Nr.364, datë 13.6.2007

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.547, DATË 9.8.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE
NATYRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 9 të vendimit nr.547, datë 9.8.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

“9/1 a) Vlera prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh, miratuar për Agjencinë Kombëtare të Energjisë, në buxhetin e vitit 2007, programi “Mbështetje për energjinë”, zëri “Studime e projekte”, të transferohet në programin “Mbështetje për burimet natyrore”, zëri “Studime e projekte”.

b) Përballimi i shpenzimeve për pagat e punonjësve që dalin të papunë nga ristrukturimi, të bëhet nga buxheti i vitit 2007, miratuar për Agjencinë Kombëtare të Energjisë, programi “Mbështetje për energjinë” prej 1 800 000 (një milion e tetëqind mijë) lekësh, zëri “Shpenzime korrente”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha